



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:059874

Datë: 27.12.2024

Numri i dokumentit: 06661451

P.nr.304/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me bashkëpunëtoresh profesionale Leonita Lajçi-Muçaj, në çështjen penale kundër të pandehurës E.K, nga, për shkak të veprës penale “*Ngasja në gjendje të paafte apo të dehur*” nga neni 371 par.2 e lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjë P/II.nr.181/2024 të datës 04.04.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datën 10.12.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurës E.K, mbrojtësin e saj e caktuar sipas detyrës zyrtare av.Egzon Berlajolli, nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare, me datën 12.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 27.12.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura:

E.K, e atësisë H. dhe amësisë Xh., e vajzërisë, e lindur me në Klinë, me vendbanim në rr. “.....”, ..., Komuna e Klinës, ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së dobët ekonomike, e pa martuar, e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me Nr....., posedon nr. të telefonit, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Për shkak të:

Me dt. 25.01.2024, rreth orës 23:00 minuta, në rrugën “.....” në Pejë, drejton automjetin nën ndikim të alkoolit dhe me këtë shkakton aksident në komunikacionin rrugor, në atë mënyrë që e pandehura duke qarkulluar me veturën e saj të llojit “.....” ngjyrë, me targa, sapo arrin tek market “.....”, në gjendje të dehur nuk mban distancën mes automjeteve në rrugë ku me pjesën e parë ballore të automjetit e godet prapa automjetin llojit “.....” ngjyrë e, me targa të cilën e voziste i dëmtuari D.Z, duke i shkaktuar lëndime trupore pasagjerit A.K dhe atë kontuzion i qafës dhe art L/S, të shoqëruara me dëmtim

të përkohshëm të shëndetit dhe si të tilla bëjnë pjesë në Lëndime të Lehta Trupore, pas matjes së alkoolit me AlcoQuant ka rezultuar se e pandehura ishte në gjendje të dehur në vlerë prej 1.38 promila,

-Me çka ka kryer veprën penale “Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur” nga neni 371 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, në aplikim të nenit 7, 8 par.1, 17, 21, 38, 39, 40, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 371 par.2 lidhur më par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 360, 365, 450, 453, 460, 462, të KPPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I. Me **DËNIM ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej një (1) viti, e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura brenda periudhës së verifikimit prej dy (2) vite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.
- II. Nëse e pandehura brenda periudhës së verifikimit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi kryen vepër tjetër penale, dënimi i kushtëzuar nga pika I e këtij dispozitivi do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- III. Obligohet, e pandehura që të paguajë shpenzimet e procedurës penale ashtu që për ekspertizën mjeko-ligjore të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) euro, ne emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- IV. Të dëmtuarit: D.Z, me vendbanim në rrugën “.....” nr..., në Pejë, si dhe A.K, me vendbanim në rrugën “.....” nr..., në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 04.04.2024, ka ngritur aktakuzën P/II.nr.181/2024, ndaj të pandehurës E.K, nga Klina, për shkak të veprës penale “Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur” nga neni 371 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestar, me datën 10.12.2024, në të cilën kanë qenë prezentë Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, e pandehura E.K, se bashku me mbrojtësin e saj av.Egzon Berljajlli, nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, pasi që të pandehurës nga ana e gjykatës i janë komunikuar të drejtat dhe detyrimet e saja ligjore, si dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit dhe pasi që gjykata është bindur së e akuzuara ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale, të pandehurës i është dhënë mundësia që të deklarohet mbi fajësinë, por paraprakisht i janë shpjeguar kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ashtu që e njëjta me vullnet të plotë ka deklaruar së pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, respektivisht për veprën penale “*Ngasje në gjendje të paaftë apo te dehur*” nga neni 371 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës, pa asnjë ndryshim.

Në vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurës Rexhep Dautaj, gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, i cili ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës. Me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës të lartcekur është pajtuar edhe mbrojtësi i të pandehurës E.K, av.Egzon Berljajlli, i cili ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, i njëjti është bere në konsultim të mjaftueshëm me mua si mbrojtës dhe i kërkoj gjykatës qe të njëjtit t'i aprovohet pranimi i fajësisë.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par.2 nën par.2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Gjyqtarja e vetme gjykuese duke vlerësuar pranimin e fajësisë së bërë nga ana e të pandehurës, në bazë të nenin 242 par.2 nën par.2.1 e deri 2.4 të KPPRK-së, vlerësoi dhe gjeti së e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, së këtë pranim të fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, dhe pasi që i janë komunikuar të gjitha të drejtat sipas KPPRKsë, së një pranim i tillë i fajësisë ka mbështetje në faktet e çështjes si dhe në materialet e dorëzuara nga Prokuroria siç janë: *Akt-Ekspertimi mjeko-ligjor i Dr. A.G. i datës 13.02.2024, Procesverbali mbi vend shikimin e aksidentit, Deklarata e të dëmtuarit D.Z e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me datë 25.01.2024, Deklarata e të dëmtuarit A.K e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me datë 25.01.2024, Deklarata e dëshmitarit A.M. e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me datë 25.01.2024, Deklarata e të pandehurës E.K e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me datë 27.01.2024 dhe në PTH në Pejë me datë 29.03.2024, foto-dokumentacioni i vendit të ngjarjes, dhe së aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që në bazë të nenit 242 par. 6 të KPPK-së, me aktvendim ka aprovuar pranimin e fajësisë nga e pandehura pasi që është bindur plotësisht se e pandehura ishte e vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë dhe se e pandehura e ka pranuar fajësinë pa presion dhe me vullnetin e saj të plotë, duke vazhduar me shqiptimin e dënimit, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par. 6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës.*

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit konform nenit 356 të KPPRK-së, pasi që nuk ka nevojë për një seancë të tillë, gjykata ka vazhduar seancën duke i ftuar palët që të deklarohen në fjalën e tyre lidhur me rrethanat për shqiptimin e dënimit.

Sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, i propozoi gjykatës: *që në kuptim të rrethanave rënduese i propozojë gjykatës të marrë parasysh ndonjë dënim të mëparshëm eventual ndaj të pandehurës ndërsa si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.*

Mbrojtësi i të pandehurës E.K, av.Egzon Berljolli, ka deklaruar se: *gjykatës i propozoj si rrethana lehtësuese të merr parasysh faktin se e njëjta ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës, ka pasur sjellje korrekte, të njëjtës i vie keq për rastin që ka ndodhur, ka vepruar në pakujdesi, është e re dhe është e pa punë, po ashtu e njëjta nuk ka qene e dënuar me pare, i propozoj gjykatës një dënim me gjobe meqenëse për këtë vepër penale parashihet, dhe me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit por që njëkohësisht nuk do ta rendonte gjendjes e saj ekonomike.*

E pandehura E.K, ka deklaruar se: *se pajtohem me deklarimin e mbrojtësit tim, jam penduar për veprën penale që kam kryer, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, që nga ajo ditë nuk i kam takuar të dëmtuarit.*

Nga faktet e vërtetuara nga shkresat e lëndës, nga deklarimet e palëve në procedurë dhe nga vet pranimi i fajësisë nga e pandehura, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurës, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtores të njëjtën pasi që më parë gjeti se penalisht është përgjegjës.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do t'a zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurës, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurës si rrethana lehtësuese ka marr parasysh faktin se e njëjta e ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale që akuzohet, ka shprehur keqardhje dhe pendim të thellë, sjelljen e të pandehurës pas kryerjes së veprës penale, pasi që ka qene hera e parë që ka renë ndesh me ligjin dhe premtimin që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërkaq si rrethana rënduese përtej elementeve të veprës penale gjykata mori faktin se janë dy të dëmtuar në këtë çështje penale, andaj dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata të pandehurës i shqiptoi dënim me kusht si në pikën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par.3, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se

dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimin mbi dënimin e përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shqiptimin e dënimit të kushtëzuar, gjykata e mori në kuptim të nenit 47, 48 si dhe 49 par.1 sipas të cilit *“Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”*, ndërkaq në par.4 përcaktohet se: *“Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale”*.

Ndërkaq, në përputhje me dënueshmërinë e përcaktuar sipas nenit 371 par.2 të KPRK-së, për veprën penale *“Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur”*, sipas të cilit përcaktohet se: *“Kushdo që drejton automjetin në gjendje të paaftë apo nën ndikim të alkoolit nëse në gjak ka alkool mbi 0,5 g/kg respektivisht me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë apo të substancave tjera dehëse nëse shkaktohet aksident dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet., ndërkaq paragrafi 2, përcakton se: “Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej pesëmijë (5.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.”*, gjykata vlerëson se dënimi me kusht sa i përket dënimit me burg do të arrijë qëllimin e dënimit. Për më tepër gjykata vlerëson se tërheqja e vërejtjes të të pandehurës se nëse në periudhën verifikuese prej 2 vitesh do të kryej veprë tjetër penale ndaj saj do të ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, është një paralajmërim serioz që e njëjta të parandalohet në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Vendimi për revokimin e dënimit me kusht nëse e pandehura brenda periudhës së verifikimit kryen veprë tjetër penale, është marrë konform nenit 50 par.2 të KPRK-së, andaj ka vendosur si në pikën e III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi si në pikën e V të dispozitivit të këtij aktgjykimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurën e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit: D.Z me vendbanim në rrugën “.....” nr., në Pejë si dhe A.K, me vendbanim në rrugën “.....” nr., në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, e në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Mbi bazën e të dhënave si më lart dhe në mbështetje të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.304/24, me datën 27.12.2024.

Bashkëpunëtore profesionale:

Gjyqtarja e vetme gjykuese:

Leonita Lajçi-Muçaj

Blerta KERMENDI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.